

Procesi Legjislativ dhe Përfshirja e Shoqërisë Civile në Vendimmarrje

Analizë Politikash

/2020



Procesi Legjislativ dhe Përfshirja e Shoqërisë Civile në Vendimmarrje

Autor: **Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)**

Programi: **Zhvillim i qëndrueshëm**

Publikimi: **Shtator 2020**

Foto e ballinës: **Pexels**



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Ky punim është publikuar me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED). Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

P[rmabajtja

Hyrje	2
Kush ka të drejtë të iniciojë një ligj	3
Agjenda legislative.....	4
Procedurat brenda Qeverisë.....	4
Hartimi fillestar i projektligjit;.....	5
Konsultimi paraprak;.....	6
Konsultimi publik;.....	6
Finalizimi i projektligjit;	7
Procedurat për dërgim në shqyrtim dhe miratim nga Qeveria;.....	8
Shqyrtimi dhe miratimi nga Qeveria;	9
Procedurat e Kuvendit.....	10
Shqyrtimi dhe miratimi nga Kuvendi;.....	10
Shpallja nga Presidenti i Republikës së Kosovës;.....	11
Sigurimi i zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore.	11
Përfundim	15

Hyrje

Manuali për angazhimin e organizatave të shoqërisë civile ka për qëllim trajtimin e hapave në të cilat kalon një ligj që nga konsultimet e para publike e deri tek evaluimi i një politike të caktuar. Ka shumë faza në të cilat politika e aplikuar merr formë dhe përmbajtje përfundimtare. Andaj monitorimi i procesit deri tek aprovimi i ligjit është shumë i rëndësishëm.


Parimet e qeverisjes së mirë dhe legjislacioni i aplikuar në Kosovë e mundësojnë pjesëmarrjen aktive të të gjithëve në politikbërje. Politika publike përshkruan veprimet e qeverisë, ndaj çështjeve të cilat paraqiten ndaj vendimmarrësve. Politikat vijnë në formën e ligjeve dhe rregulloreve. Politikëbërja nën një qeverisje të mirë është rezultat i konsultimeve të gjera brenda një procesi gjithëpërfshirës të vendimmarrjes.

Parimet e qeverisjes së mirë dhe legjislacioni i aplikuar në Kosovë e mundësojnë pjesëmarrjen aktive të të gjithëve në politikbërje. Kjo, qoftë duke përfaqësuar ndonjë grup të interesit apo vetëm me pjesëmarrje aktive në vendimmarrje. Kjo bëhet e mundur përmes pjesëmarrjes aktive në diskutime publike, adresim të kërkesave tek institucionet e duhura etj.

Baza ligjore aktuale e mundëson pjesëmarrjen aktive në vendimmarrje për të gjithë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, promovon parimet e qeverisjes së mirë ku përfshihet edhe përfshirja e sa më shumë palëve gjatë procesit ligjvënës. Më tutje, Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile, në të cilin dokument paraqiten parimet bazë dhe mënyrat e përfshirjes së OSHC-ve në vendimmarrje.

Qeveria e Kosovës ka miratuar për herë të parë Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile në korrik të vitit 2013, dokument ku janë paraqitur parimet bazë dhe mënyrat e përfshirjes së OSHC-ve në vendimmarrje.¹ Përveç kësaj strategjie, baza ligjore është e mjaftueshme për të realizuar pjesëmarrjen aktive të organizatave të shoqërisë civile në procesin e politikëbërjes.

¹ file:///C:/Users/Lenovo/Downloads/Strategjia-Qeveritare-per-bashkepunim-me-shoqerine-civile-2019-2023_opt.pdf



Kush ka të drejtë të iniciojë një ligj

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të drejtën e inicimit të një ligji e gëzon presidenti i Kosovës, Qeveria, deputetët dhe qytetarët me dhjetëmijë nënshkrime. Në këtë mënyrë është e mundshme që me mobilizimin e dhjetë mijë nënshkrimeve të bëhet e obligueshme inicimi i një legjislacioni përkatës. E drejta e inicimit të një ligji kushtimisht mund të themi që i takon secilit qytetar të Kosovës. Varësisht nga pozicioni në të cilin ndodhesh mund të ushtrosh instrumente të ndryshme për të realizuar këtë të drejtë.

Për shembull, nëse je deputet, mund të propozosh në mbledhje të grupit parlamentar, apo të inicosh një gjë të tillë në mbledhje të Komisionit në të cilin bënë pjesë. E nëse çështja që të intereson, nuk është pjesë e punës së Komisionit tënd, këtë mund ta shtysh përpara përmes deputetëve të tjerë, pjesë e partisë tënde.

Megjithatë, jo të gjithë qytetarët e Kosovës janë deputet. Ky status u takon vetëm 120 qytetarëve të zgjedhur. Një qytetar i thjeshtë ka megjithatë, disa instrumente shtesë për të realizuar të drejtën e tij për nismë legjislative. Përmes aktiviteteve vetëdijësuese mund të mbledhësh 10 mijë nënshkrime për të iniciuar procedurat për hartimin e një ligji.

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e drejta e inicimit të Nismës Legjislative i takon Presidentit të Republikës, Qeverisë, deputetëve dhe së paku dhjetëmijë qytetarëve.

Në një mënyrë ose tjetrën, të gjithë qytetarët mund të jenë pjesë e një nisme legjislative.

Miratimi i ligjeve dhe akteve të tjera ligjore bëhen në Kuvend me shumicë të votave nga deputetët, të cilët janë përfaqësues të popullit. Pas miratimit të ligjit në Kuvend dhe nënshkrimit nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës, ligji dërgohet për nënshkrim tek Presidenti i Republikës së Kosovës. Presidenti i Republikës së Kosovës gëzon të drejtën që të kthej një ligj në Kuvend, këtë të drejtë mund ta ushtroj vetëm një herë.

Agjenda legjislative

Janë një sërë faktorësh që e diktojnë agjendën legjislative të Qeverisë. Ato kryesisht përcaktohen nga programi qeverisës, kërkesat e grupeve të ndryshme të interesit etj. Në radhë të parë ajo përcaktohet nga programi qeveritar. Roli i programit qeverisës është në orientimin e politikave dhe reformave të nevojshme për realizimin e këtyre politikave.

Përveç agjendës legjislative të Qeverisë, edhe Kuvendi i Kosovës mund të marrë pjesë në hartimin e ligjeve. Duke qenë se e ka këtë të drejtë kushtetuese, edhe Kuvendi mund të plotësojë agjendën legjislative. Ngjashëm, edhe Presidenti mund ta bëjë këtë. Nismën legjislative mund ta merr një deputet, një komision apo një grup parlamentar.² Nisma legjislative e tillë, pas kalimit në kryesinë

Kushtetuta e Kosovës – Neni 79

Nismën për të propozuar ligje, mund ta marrë Presidenti i Republikës së Kosovës nga fushëveprimtaria e saj/tij, Qeveria, deputetët e Kuvendit, ose më së paku dhjetëmijë qytetarë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

e Kuvendit dhe futjen në rendin e ditës, nëse miratohet në mbledhjen e Qeverinë e Kosovës.

Edhe pse në masë të madhe agjendën e përcakton Qeveria, ajo mund të jetë e ndikuar nga

kërkesat dhe mbështetjet e jashtme.


Procedurat brenda Qeverisë

Pasi që çështja ka hyrë në Programin Legjislativ, ndjekja e të gjitha procedurave nga ana e Qeverisë bëhet e obligueshme. Programi Legjislativ ka për qëllim lehtësimin e menaxhimit dhe monitorimit

² Kuvendi i Kosovës, (2010), Rregullore e Punës së Kuvendit, Neni 55, Nisma për Hartimin e Projektligjit, faqe 25, Prishtinë, e qasshme në http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rr_K_RK_29_04_2010_shqip.pdf.


të iniciativave legislative të Qeverisë.³ Bazuar në sistemin politik të Kosovës, është Qeveria ajo që harton pjesën më të madhe të ligjeve.

Sa i përket bazës ligjore, procedurat ligjëvënëse në Qeveri janë të përcaktuara me dy akte nënligjore kryesore, Udhëzimi Administrativ 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative dhe Rregullorja Nr.13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar dhe Rregullorja 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar. Këto dy akte të brendshme të Qeverisë e rregullojnë procedurën brenda organit ekzekutiv.



Hartimi fillestar i projektligjit;

Pjesa e hartimit fillestar të projektligjit, fillon me formimin e grupit punues, pasi që ligji ka hyrë në agjendë. Kjo është e rregulluar me akt të brendshëm të Qeverisë. Me anë të Rregullores për Shërbimin Qeveritar është rregulluar procedura për projektligjet në fjalë.



Hyrja në agjendë i paraprinë hartimit fillestar të projektligjit. Pasi që ligji të hyjë zyrisht në Agjendën Legjislative të Qeverisë mbledhet grupi punues i cili e harton Projektligjin në fjalë. Grupin punues e udhëheqë zyrtaari përgjegjës i Ministrisë të cilin paraprakisht e ka zgjedhur Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë përkatëse deri tek hartimi i draftit të parë për konsultim paraprak.

³ Qeveria e Republikës së Kosovës, (2013), Rregullore Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar, faqe 6, Prishtinë.

Konsultimi paraprak;

Kjo është fazë e brendshme e konsultimit në të cilën zyrtari përgjegjës sigurohet që janë njoftuar të gjitha palët që potencialisht mund të jenë të interesuara. Kjo në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë, në mënyrë që këto palë të kenë mundësinë e komentimit para se ligji të draftohet. Gjatë fazës së konsultimit paraprak, ministrinë përkatëse janë po ashtu të obliguara që të publikojnë në ueb sajtet e tyre projekt aktet normative.

Organet përkatëse mund të dërgojnë komentet e tyre në afat prej 15 ditësh pune.⁴ Kjo është një periudhë në të cilën palët e prekura nga legjislacioni mund të dërgojnë komentet e tyre. Palët e përfshira në këtë proces, por edhe në fazën e konsultimit publik dhe të finalizimit të projektligjit, duhet të renditen në memorandum shpjegues.⁵ Në memorandumet shpjeguese zakonisht përmenden palët e konsultuara por nuk bashkangjitet një tabelë me komentet kyçe nga ana e këtyre palëve, ndonëse kjo është e obligueshme me këtë Udhëzim Administrativ.

Konsultimi publik;

Konsultimi publik është detyrim ligjor që del jo vetëm nga Rregullorja e Punës së Qeverisë por edhe nga Plani Nacional me rastin e anëtarësimit të Kosovës në nismën Open Government Partnership. Në konsultimin publik mund të marrin pjesë të gjitha palët e interesuara përfshirë organizatat e shoqërisë civile, por edhe qytetarë të thjeshtë.

E drejta për pjesëmarrje në aktivitete publike është e definuar edhe në Kushtetutën e Kosovës, përkatësisht në nenin 45 të saj. Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht në nenin 45 të saj, e drejta për pjesëmarrje në aktivitete publike dhe ndikimit në mënyrë demokratike i takon secilit nga ne.

Kushtetuta e Kosovës - Neni 45

Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.

⁴ Ibid, faqe 14.

⁵ Qeveria e Republikës së Kosovës, (2013), Udhëzimi Administrativ 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, faqe 52, Prishtinë.

Në bazë të Rregullores së Qeverisë 5/2016 mbi Standardet Minimale për Procesin e Konsultimeve Publike, çdo person gëzon të drejtën që të ndikoj në mënyrë demokratike në vendimet publike. Qëllimi kryesor i Rregullores 5/2016 është nxitja dhe sigurimi i një procesi të konsultimit publik ndërmjet organeve publike, palëve të interesuara dhe publikut⁶, me qëllim të gjithëpërfshirjes në procesin politikëbërës dhe vendimmarrës.

Bazuar në rregulloren 5/2016, Zyra e Kryeministrit- Zyra për Qeverisje të Mirë është obliguar të krijoj platformën online <https://konsultimet.rks-gov.net/>. Kjo platformë shërben për monitorim të konsultimeve publike.

Planet vjetore të organeve publike i nënshtrohen procesit të konsultimeve publike duke u bazuar në këtë rregullore. Përveç të planeve vjetore konsultimeve publike i nënshtrohen:

- Projekt Plani vjetor i dokumenteve strategjike;
- Projekt programi legjislativ i Qeverisë;
- Projekt plani i akteve nënligjore;
- Projekt lista e koncept dokumenteve;
- Projekt koncept dokumentet;
- Projekt aktet normative;
- Projekt strategjitë;⁷

Në konsultimin publik të organizuar nga Qeveria, janë zyrtarët ligjor ata që mund ti përgjigjen secilës brengë dhe shqetësim. Gjithashtu, është obliguese që rezultatet e konsultimit publik të pasqyrohen në memorandum shpjegues.

Finalizimi i projektligjit;


Pas përfundimit të hartimit të projektligjit, zyrtari përgjegjës i zgjedhur nga Sekretari i Ministrisë ia dërgon projektligjin drejtorit të departamentit ligjor të ministrisë përkatëse. Ky i fundit, nëse nuk ka ndonjë vërejtje, e dërgon projektligjin për miratim brenda ministrisë përmes Sekretarit të përgjithshëm të asaj ministrie. Nëse projektligji nuk plotëson standardet e legjislacionit në fuqi,

⁶ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, (2020), Rregullore Nr. 5/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik. E qasshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15036>

⁷ Zyra e Kryeministrit-Zyra për Qeverisje të mire. E qasshme në:<https://konsultimet.rks-gov.net/>

departamenti ligjor e harmonizon atë me dispozitat kushtetuese apo ligjore.⁸ Nëse është e nevojshme, konsultohet edhe Departamenti i së Drejtës së BE-së.

Kur procedurat përfundojnë brenda ministrisë, Ministri jep pëlqimin e tij për procedim të mëtutjeshëm në Departamentin e së Drejtës së BE-së dhe në Ministrinë e Financave. Ministria e Financave duhet të lëshojë Deklaratën mbi Ndikimin Buxhetor dhe Departamenti i së Drejtës së BE-së, duhet të lëshojë Opinionin e Përputhshmërisë me Acquis të BE-së. Grafikiht:



Procedurat për dërgim në shqyrtim dhe miratim nga Qeveria;

Pas përfundimit të të gjitha procedurave të përshkruara më sipër, Drejtori i Departamentit Ligjor të Ministrisë përkatëse e dërgon pakon e dokumenteve tek Zyra e Kryeministrit. Kjo pako duhet të përmbajë:

- Shkresën përcjellëse zyrtare të dërguar nga drejtori i departamentit ligjor të ministrisë përkatëse të aprovuar nga sekretari i përgjithshëm dhe ministri;
- Versionin final të projekt aktit normativ;
- Memorandumin shpjegues ku përfshihet edhe një tabelë ku listohen komentet e marra nga institucionet tjera;
- Deklaratën e Përputhshmërisë (DeP) me Acquis të BE-së të lëshuar nga Ministria bartëse;
- Tabelat e Përputhshmërisë (TeP) të plotësuara nga Ministria bartëse;

⁸ Qeveria e Republikës së Kosovës, (2013), Rregullore Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar, faqe 14, Prishtinë.

- Deklarata për Ndikimin Buxhetor nga ministria përkatëse për financa;
- Opinioni i Përputhshmërisë me Acquis të BE-së nga Ministria përkatëse për Integritet Evropian;
- Ndonjë raport tjetër ose dokument që vendos ministria apo që mund të përcaktohet me legjislacion tjetër;

Këto dokumente duhet të dërgohen tek Zyra e Kryeministrit për procedim të mëtutjeshëm.

Shqyrtimi dhe miratimi nga Qeveria;

Faza e shqyrtimit dhe Miratimit të Projektligjit nga ana e Qeverisë fillon me Procedurën Paraprake. Në këtë procedurë, Zyra Ligjore brenda Zyrës së Kryeministrit e shqyrton konsistencën e aktit normative me dispozitat kushtetuese dhe ligjore si dhe shqyrton procedurën e ndjekur. Nëse nuk plotësohen të gjitha kushtet e parapara në legjislacion, zyra ligjore, bashkë me një arsyetim, e kthen prapa aktin normative dhe kërkon ndryshimin ose rishkrimin e tij.⁹ Gjithashtu, është e mundshme që Zyra Ligjore, në bashkëpunim me Kabinetin e Kryeministrit të bëjë ndryshimet e nevojshme në projekt aktin normativ.

Pas marrjes së rekomandimit për miratim nga ana e zyrës ligjore si dhe deklaratës së pajtueshmërisë së aktit normativ me dispozitat e Rregullores së Punës, Qeveria vendosë për miratimin e projektligjit. Në rastet kur Qeveria nuk miraton aktin normativ, ky i fundit i kthehet organit propozues. Në rast se projektligji kthehet i pa miratuar nga Kuvendi, ai i kthehet Ministrisë përkatëse.

⁹ Qeveria e Republikës së Kosovës, (2013), Rregullore Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar, faqe 14, Prishtinë.

Procedurat e Kuvendit

Kuvendi i Kosovës, për ndjekjen e procedurave për miratimin e një legjislacioni të caktuar, konsultohet me Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës. Ky është dokumenti bazë, në të cilin përshkruhen të gjitha aktivitetet që duhen ndërmarrë për miratimin e një akti legjislativ. Kuvendi si organ ligjvënës ka përcaktuar disa faza të miratimit të legjislacionit në pajtim me praktikën



parlamentare dhe parimeve të përgjithshme të parlamentarizmit.

Shqyrtimi dhe miratimi nga Kuvendi;

Pasi që projektligji bashkë me memorandumën shpjegues janë sjellë në Kuvend nga ana e Qeverisë, sekretariati i Kuvendit, përmes Koordinatorit të Komisionit përkatës funksional ose të përhershëm, e dërgon materialin tek anëtarët e Komisionit. Komisioni funksional e shqyrton dhe miraton në parim projektligjin dhe i njëjti është i gatshëm për seancë plenare.

Gjatë punimeve të seancës, fillimisht diskuton propozuesi i projektligjit, pastaj kryetari ose raportuesi i komisionit funksional, kryetarët e komisioneve parlamentare, kryetarët e grupeve parlamentare dhe deputetët që lajmërohen për diskutim.¹⁰ Pas diskutimit, projektligji hidhet në votim për lexim të parë dhe nëse miratohet, i dërgohet prapë Komisionit funksional për amendamentim të mëtejshëm.

Komisioni ka të drejtën e organizimit të dëgjimeve publike në të cilat ftohen të gjitha palët që preken nga ndryshimi në legjislacion, si grupet e ndryshme të interesit, organizata të shoqërisë civile, misione ndërkombëtare etj. Rekomandimet e tyre në dëgjim publik merren për bazë gjatë punës në grupin punues brenda Komisionit.

Përveç anëtarëve të vet, Komisioni ka të drejtë të ftojë në grupin punues edhe anëtar të tjerë të interesuar por pa të drejtë vote. Grupi punues po ashtu, sipas nevojës, mund të organizojë vizita në terren për të parë gjendjen aktuale dhe implikimet e mundshme që mund të sjellë ndryshimi i propozuar në legjislacion. Pas hartimit të amendamenteve finale, Komisioni mbledhet dhe miraton

¹⁰ Kuvendi i Kosovës, (2010), Rregullore e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, faqe 17, Prishtinë.

një nga një këto amendamente dhe projektligji sërisht i kalon në procedurë Komisioneve të përhershme.

Procedura vazhdon sërisht me futjen në agjendën e seancës së Kuvendit, miratimin në lexim të dytë të aktit ligjor. Seanca e Kuvendit e miraton në lexim të dytë Projektligjin pasi ka shqyrtuar dhe eventualisht miratuar një nga një amendamentet nga Komisioni funksional dhe/ose nga Komisionet e Përhershme.

Shpallja nga Presidenti i Republikës së Kosovës;

Në pajtim me Rregulloren e Punës së Kuvendit, Kryetari i Kuvendit nënshkruan ligjin e miratuar në afat prej 10 ditësh nga data e miratimit në Kuvend. Ligji i nënshkruar nga Kryetari i Kuvendit i dërgohet Presidentit të Republikës për shpallje.¹¹ Presidenti i Republikës në pajtim me nenin 84, pikën 5 të Kushtetutës së Kosovës ka të drejtën e shpalljes së ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës.¹² Natyrisht, Presidenti i Republikës, ka të drejtën që ta kthejë Ligjin në fjalë dhe të mos e miratojë atë.

Në rast se Presidenti i Republikës e kthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryesia e Kuvendit ia dërgon menjëherë Komisionit Funksional raportues për shqyrtim. Pas shqyrtimit, Komisioni Funksional dërgon raportin me rekomandime për çështjet që përmban vendimi i Presidentit. Pas shqyrtimit, Kuvendi, me shumicën e votave **të të gjithë deputetëve**. Nëse Kuvendi nuk e miraton rekomandimin e Presidentit, ligji mbetet ashtu siç është miratuar më parë nga Kuvendi.

Sigurimi i zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore.

Cikli ligjvënës nuk përfundon me hyrjen në fuqi të Ligjit. Procedura e evaluimit të legjislacionit është po aq e rëndësishme. Evaluimi ose mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit mund të jetë subjekt i procedurave dhe institucioneve të ndryshme si:


- Mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit nga ana e Komisionit përkatës të Kuvendit.
- Nëse në Raportin e Progresit bëhet thirrje për ndryshime në legjislacion.
- Nëse Qeveria e Kosovës bëhet pjesë e ndonjë ndërmarrje rajonale që kërkon ndryshime në legjislacion. Marrëveshja me OGP është një shembull i kësaj.

Zakonisht, mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit, e inicuar nga ana e Komisionit përkatës të Kuvendit është bazë e fortë për ndryshime në legjislacion. Organizatat e shoqërisë civile mund të ndikojnë në futjen në agjendë të monitorimit të zbatimit të legjislacionit. Rekomandimi i

¹¹ Kuvendi i Kosovës, (2010), Rregullore e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, faqe 17, Prishtinë.

¹² Gazeta Zyrtare, (2008), Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kompetencat e Presidentit, faqe 31, Prishtinë.

Komisionit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit është bazë e mjaftueshme që Qeveria ta fusë në Programin Legjislativ atë ligj.



Përcjellja e ligjeve

Kuvendi i Kosovës në çdo legjislaturë ka 120 deputetë, të cilët me shumicë votash kalojnë vendime dhe ligje. Andaj është e rëndësishme që mbledhjet e komisioneve dhe seancat të monitorohen, në mënyrë që të ketë përfshirje më të madhe në vendimmarrje.

Monitorimi i proceseve ligjore është tejet e rëndësishme për demokracinë e një vendi. Në Kosovë monitorimi i një ligji mund të përcjellet në faqen e Kuvendit të Kosovës¹³. Në kuadër të kësaj faqe secili qytetarë dhe organizatë nga shoqëria civile mund të informohet në tërësi për procesin nga propozimi i ligjit e deri tek publikimi i tij në gazetë zyrtare.



Propozimi i një ligji, propozim ky i cili mund të jetë nga: Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria, deputetët e Kuvendit, komisioni parlamentar, grupi parlamentar së paku nga 6 deputet dhe me dhjetë mijë nënshkrime nga qytetarët e përcaktuar në Kushtetutë të Kosovës përkatësisht në nenin 79 të saj.

¹³ <http://www.kuvendikosoves.org/>

Pas propozimit të ligjit krijohen grupe punuese në komisionet përkatëse. Komisionet parlamentare kanë funksion legjislativ dhe mbikëqyrës të Kuvendit. Kuvendi i Kosovës emëron komisione të përhershme, komisione funksionale dhe komisione ad hoc.

përgjegjëse varësisht nga fushëveprimi që mbulon ligji. Projektligjet zakonisht shqyrtohen në dy lexime. Në këto komisione bëhet shqyrtimi i amandamentimeve, baza ligjore dhe aspekti financiar të cilat paraqiten në Kuvend me rekomandimet e marra.


Në Kuvendin e Kosovës janë 15 Komisione parlamentare:

- Komisioni për Buxhet dhe Transfere
- Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
- Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit
- Komisioni për Integrim Evropian
- Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë
- Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport
- Komisioni për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike
- Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Infrastrukturë dhe Mjedis
- Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- Komisioni për Qeverisje Lokale, Administratë Publike, Zhvillim Rajonal dhe Media
- Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes
- Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione
- Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
- Komisioni për mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Intelejencë

Në rastet kur kemi përfshirje të komuniteteve jo shumicë, projektligji dërgohet edhe në komisionin për kthim dhe komunitete. Pas miratimit të ligjit në Kuvend, Presidenti i Republikës së Kosovës gëzon të drejtën që të kthejë ligjin për plotësim në Kuvend, apo t`a aprovoj ku pas aprovimit në periudhë prej 15 ditësh hyn në fuqi.

Po ashtu në këtë ueb faqe mund të dërgohen pyetje drejtuar deputetëve të Republikës së Kosovës.

Më poshtë është paraqitur organogrami i cili tregon hapat nëpër të cilat kalon një ligj që nga propozimi i tij.



Strategjia qeveritare për bashkpunim me shoqërinë civile është aprovuar për herë të parë në korrik të vitit 2013. Në këtë strategji qeveritare janë paraqitur katër objektiva kryesore për përfshirjen e shoqërisë civile në politikëbërje:

Objektiva 1. Rritja e Pjesëmarrjes së Shoqërisë Civile në Politikëbërje

- 1.1 Përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve për zbatimin e standardeve minimale për konsultime me publikun.
- 1.2 Ngritja e njohurive të qytetarëve dhe shoqërisë civile për konsultimet.

1.3 Përmirësimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të kontribuar në procesin e politikë-bërjes.

Objektiva 2. Përmirësimi i Kornizës Institucionale dhe Ligjore për Financim në Zhvillimin e Qëndrueshëm të Programeve dhe Projekteve të OSHC-ve me Interes Publik

2.1 Fuqizimi i kapaciteteve të Ministrive dhe Komunave për zbatimin e standardeve për financimin publik të OSHC-ve.

2.2 Përmirësimi i kornizës ligjore dhe institucionale për zhvillimin e filantropisë individuale dhe të korporatave.

2.3 Rregullimi i ndarjes së pronës publike për shfrytëzim nga OSHC-të.

2.4 Krijimi i një sistemi të bashkëfinancimit për projektet e OSHC-ve të mbështetura nga BE-ja.

Objektiva 3. Zhvillimi i Praktikave dhe Procedurave për Kontraktimin e OSHC-ve për Ofrimin e Shërbimeve Publike.

3.1 Përmirësimi i kornizës së përgjithshme ligjore dhe institucionale për rregullimin e aktiviteteve ekonomike të OSHC-ve

Objektiva 4. Rritja e Vullnetarizimit në Programet me Interes Publik¹⁴

Përfundim

Cikli i ligjvënies në Kosovë nuk është i ndryshëm nga parimet teorike të një cikli legjislativ. Siç e pamë, procedurat brenda Qeverisë janë mjaftë të komplikuar me involvimin e zyrtarëve ligjor brenda Ministrisë në njërin anë dhe brenda Zyrës së Kryeministrit në anën tjetër. Ngjashëm edhe Drejtorët e Departamenteve të ndryshme janë po ashtu pjesë e procesit të hartimit të një legjislacioni.

Përparësia e vetme e kësaj procedure të gjatë është mundësia e shumë të grupet e ndryshme të interesit dhe organizatat e shoqërisë civile kanë që të ndikojnë në përmbajtjen e politikës. Janë disa zyrtar qeveritar tek të cilët mund të avokohet për përfshirjen e rekomandimeve të caktuara. Pastaj është pjesëmarrja në Konsultimin Publik dhe dërgimi i rekomandimeve konkrete në Qeveri për miratim. Ngjashëm edhe me procedurat në Kuvend ku mund të arrihet ndikimi përmes

¹⁴Zyra e Kryeministrit (2020), Strategjia Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile. E qasshme: [Strategjia-Qeveritare-per-bashkepunim-me-shoqerine-civile-2019-2023_opt.pdf](#)

pjesëmarrjes në dëgjime publike, grupe punuese dhe përcjellje të mbledhjeve të Komisionit. Minimalisht, mundësia për të dërguar email ekziston tek së paku 11 adresa të ndryshme:

- Zyrtari përgjegjës për hartimin e projektligjit
- Zyrtari ligjor në Ministri
- Sekretari i Ministrisë
- Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit
- Anëtarët e Kabinetit Qeveritar
- Njësia për Hulumtim brenda Kuvendit të Kosovës
- Koordinatori i Komisionit përkatës të Kuvendit
- Anëtarëve të Komisionit përkatës
- Anëtarëve të Grupit punues brenda Komisionit
- Deputetëve të Kuvendit të Kosovës
- Zyrës së Presidentit

Ekzistojnë detyrime ligjore të fuqishme që obligojnë Qeverinë e Kosovës por edhe Kuvendin që të marrë për bazë opinionet e palëve të interesuara dhe shoqërisë civile në përgjithësi. Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile, plani nacional me rastin e anëtarësimit të Kosovës në Open Government Partnership dhe Rregullorja e punës së Qeverisë, obligojnë bashkëpunimin e Qeverisë me organizata të shoqërisë civile. Ngjashëm, Kuvendi ka miratuar deklaratën e bashkëpunimit të Kuvendit të Kosovës me organizata të shoqërisë civile

